



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/G2-7 Prot.
Nr. Dok. 202502600/7

Tiranë 21.07.2025

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave nga ana e Bashkisë Fier për vendosjen në vend të së drejtës së shkelur për përfitimin e bonusit e fundvitit, për qytetarët G. R. dhe G. H.*

Drejtuar: **Bashkisë Fier**

Për dijeni: **Z. Armando Subashi,**

Kryetar i Bashkisë Fier

Të nderuar,

Avokati i Popullit si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, shërben si garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjatë, si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një vëmendje të posaçme dhe ndjek e trajton me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupeve në nevojë.

Siç jeni në dijeni nga komunikimet institucionale, qytetarët G. H., 32 vjeç, dhe G. R., 35 vjeç, me aftësi të kufizuara, banues në Njësine Administrative Frakull e Madhe, Fier, ankohen për mospërfitim të mbështetjes financiare për vitin 2024, për kategoritë e veçanta, në zbatim të VKM Nr. 854, datë 26.12.2024 *“Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta, për vitin 2024”*. Sipas pretendimeve të parashtrura në ankesat e qytetarëve, ata nuk e kanë përfituar këtë bonus të fundvitit për shkak se dosjet e tyre janë dërguar me vonesë pranë NJ.A. Frakull e Madhe, Fier, nga DRSHTSH Fier.

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, Avokati i Popullit, pasi është njohur me objektin e ankesave të sipërcituara, vendosi marrjen në shqyrtim të tyre dhe nisjen e hetimit administrativ, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”* të ndryshuar¹.

Në kuadër të hetimit administrativ për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor² i kemi kërkuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier³ dhe Bashkisë Fier, informacione dhe shpjegime⁴.

Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier me shkresat përkatëse për secilin ankues⁵, informohemi se:

Z. G. H. dhe Z. G. R. janë përfitues të aftësisë së kufizuar të nivelit 2 (i moderuar), për të cilën kanë aplikuar për rikomisionim përkatësisht, në datat 05.11.2024 dhe 22.11.2024. Pas zhvillimit të intervistave dhe marrjes së vendimeve përkatëse më 01.12.2024, atyre u është njohur pagesa e aftësisë së kufizuar për periudhën 01.12.2024 – 01.12.2025. Vendimet janë përcjellë

¹ Neni 13, paragrafi i parë: *“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”*.

² Neni 63, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe neni 19 pika b, Ligji Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*.

³ DRSHTSH Fier: Shkresë nr. K1/G2-3 Prot, datë 16.04.2025, *“Kërkesë për informacion dhe shpjegime”* dhe Shkresa nr K1/G1-3 Prot. datë 16.04.2025 *“Kërkesë për informacion dhe shpjegime”*.

⁴ Bashkisë Fier: Shkresë nr. K1/G2-2 Prot, datë 16.04.2025, *“Kërkesë për informacion dhe shpjegime”* dhe shkresa K1/G1-2 Prot., datë 16.04.2025 *“Kërkesë për informacion dhe shpjegime”*.

⁵ Shkresa nr. 477/1 Prot., datë 29.05.2025 *“Informacion”* dhe shkresa nr.426/1 Prot., datë 29.04.2025 *“Informacion”*, DRSHTSH Fier.

pranë Njesisë Administrative Frakull, Bashkia Fier, më 13.12.2024, me shkresën nr. prot. 1326.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror vepron në përputhje me ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale", ku përcaktohet se përgjegjës për përgatitjen dhe ekzekutimin e listëpagesave është Bashkia, përmes strukturës për shërbimet sociale dhe administratorëve shoqërorë të njësive administrative.

Në kuadër të VKM nr. 854, datë 26.12.2024 "Për mbështetjen financiare për kategori të veçanta", është kërkuar nga bashkitë përfshirja e vendimeve të dhjetorit në listëpagesat për pagesën e bonusit të fundvitit.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror ndjek dhe zbaton të gjitha procedurat sipas ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për shqyrtimin e rasteve të tilla. Në lidhje me pretendimin e ngritur, sqarojmë se në bazë të nenit 22, pika "b" të ligjit nr. 57/2019, përcaktohet shprehimisht se: "Roli i strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki është përgatitja e listës së plotë, masave të përfitimit dhe përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar për ekzekutimin e tyre". Po ashtu, sipas nenit 23 të këtij ligji: "Administratori Shoqëror i njësisë administrative paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe masat e përfitimit, bazuar në vërtetimet dhe vendimet e komisioneve të vlerësimit, si dhe dokumentacionin për përfitime të tjera shtesë sipas legjislacionit në fuqi."

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 854, datë 26.12.2024 "Për mbështetjen financiare për kategori të veçanta", është bërë njoftimi për çdo bashki për kryerjen e pagesave mbi listëpagesat e muajit dhjetor, por gjithmonë duke marrë në konsideratë të gjitha vendimet e gjeneruara gjatë gjithë muajit dhjetor për komisionimet dhe rikomisionimet e aftësisë së kufizuar. Në korrespondencë të vazhdueshmëe njoftimesh, ju është komunikuar përfshirja në pagesën e fundvitit duke i rishikuar listëpagesat e gjeneruara.

Në kushtet kur institucioni kompetent për hartimin e listëpagesave dhe kryerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar, përfshirë përfitimet e tjera shtesë, është Bashkia Fier, kërkesa juaj do t'i përcillet Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier, për përfitimin e bonusit të fundvitit në përputhje me përcaktimet në fuqi.

Më tej, Bashkia Fier, Drejtoria e Shërbimit Social, në përgjigjet shkresore⁶ për secilin ankues, drejtuar Avokatit të Popullit, informon:

Dosja e personit⁷ me aftësi të kufizuar ka qenë në proces rikomisionimi, dhe vendimi është protokolluar në Njësine Administrative Frakull në datën 16.12.2024. Për muajin dhjetor, personi në fjalë ka qenë pa pagesw pasi vendimi ka ardhur pasi borderoja ishte hartuar dhe pagesat kishin kaluar në Thesar (kujtojmë këtu ngarkesën e madhe të Thesarit në muajin dhjetor). Për rrjedhojë, në muajin janar 2025 është kryer pagesa edhe për muajin dhjetor 2024. Kjo është arsyeja që personi nuk ka përfituar shpërblimin e fundvitit. Theksojmë se, sipas email-it të ardhur nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social lidhur me modalitetet e VKM-së nr. 854, datë 26.12.2024, sqarohet se shpërblim përfitojnë personat të cilët figurojnë me pagesë në muajin dhjetor 2024.

Sqarojmë gjithashtu se në atë periudhë ka pasur shumë dosje në proces rikomisionimi, jo vetëm nga Komisioni Biopsiko-Social, por edhe nga Komisionet Eprore të Verbërisë dhe Tetraplegjisë, të cilët për të njëjtën arsye nuk kanë përfituar shpërblimin. Rrjedhimisht, në këtë rast nuk bëhet fjalë për diskriminim, por për zbatim korrekt të udhëzimeve në fuqi.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

Politikat për mbrojtjen sociale në Shqipëri bazohen në objektivat sociale që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i përcakton si detyra themelore të shtetit për të garantuar çdo qytetari shqiptar, pavarësisht nga niveli i të ardhurave, origjina, mosha, gjinia, përkatësia etnike, niveli arsimor, orientimi seksual, identiteti kulturor, apo bindjet politike dhe fetare, kushte jetese dinjitoze dhe akses në shërbime publike cilësore, veçanërisht në lidhje me sigurimin e ushqimit bazë, strehimit, kujdesit shëndetësor dhe arsimit. Përmbushja e këtyre objektiveve kushtetuese, të cilat synojnë garantimin e mbrojtjes sociale të qëndrueshme dhe efektive për të gjithë qytetarët, me fokus të veçantë tek grupet e cënueshme dhe ato në varfëri, mbështetet në disa instrumente të rëndësishme ndërkombëtare, duke përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (OKB), Parimet e Axtendës së Kombeve të Bashkuara 2030, si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

⁶ Shkresa nr. 4889/1 Prot., datë 05.05.2025 “Plotësim informacioni” dhe Shkresa nr. 4888/1 Prot., datë 05.05.2025 “Plotësim informacioni”, Bashkia Fier”.

⁷ **Sqarim: teksti i shkresave “Plotësim informacioni” të Bashkisë Fier, është i njëjtë për të dy ankuesit.**

Në nivel kombëtar, neni 52 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e çdo qytetari për sigurime shoqërore në pleqëri ose në rast pa aftësie për punë, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, si dhe të drejtën për të përfituar ndihmë ekonomike për personat që mbeten pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tyre dhe që nuk disponojnë mjete të tjera jetese, sipas kritereve ligjore të përcaktuara.

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar për shërbimet sociale synon plotësimin e nevojave jetike të qytetarëve dhe familjeve në vështirësi ekonomike e sociale. Në mënyrë të veçantë, për familjet dhe individët në nevojë për mbështetje, është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse të punojnë në mënyrë të koordinuar dhe bashkëpunuese, duke garantuar identifikimin dhe vlerësimin e çdo rasti me qëllim ofrimin e mbrojtjes së duhur sociale.

Ligji Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” përcakton si objektiv të tij kryesor reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social, duke krijuar mundësi integrimi dhe duke siguruar një sistem ndërhyrjesh dhe shërbimesh sociale efektive që kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës së individëve dhe familjeve në vështirësi ekonomike (neni 1, pika b). Ky ligj parashikon në mënyrë specifike sigurimin e ndihmës ekonomike dhe përfitimeve për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet që nuk mund të plotësojnë nevojat bazë jetike, duke synuar zhvillimin e aftësive personale, ruajtjen e integritetit dhe garantimin e përfshirjes sociale, pavarësisht kufizimeve ekonomike, fizike, psikologjike apo shoqërore (neni 2, pika a dhe b). Gjithashtu, ky ligj synon edhe mirëorganizimin dhe funksionimin efektiv të institucioneve publike që kanë përgjegjësi për administrimin dhe ofrimin e asistencës sociale (neni 2, pika ç).

Për të përmbushur detyrimet sociale ndaj kategorive vulnerabël të popullsisë dhe për të kontribuar në reduktimin e pabarazive sociale dhe ekonomike në vend, në fund të vitit 2024, Këshilli i Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, miratoi Vendimin nr. 854, datë 26.12.2024, “*Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta, për vitin 2024*”. Ky vendim parashikon dhënien e një shpërblimi financiar të njëhershëm në masën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për disa kategori vulnerabël të trajtuara nga sistemi i mbrojtjes sociale. Në zbatim të këtij vendimi, përfitues të mbështetjes financiare u përcaktuan familjet që trajtohen

me ndihmë ekonomike⁸, përfshirë edhe ata që përfitojnë nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, fëmijët pa kujdes prindëror të vendosur në familje kujdestare, personat me aftësi të kufizuar⁹, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë¹⁰, personat me verbëri¹¹, si dhe ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuara¹².

Qëllimi i masës ishte lehtësimi i barrës ekonomike të këtyre kategorive në periudhën e festave të fundvitit, një periudhë që tradicionalisht karakterizohet nga shtim i shpenzimeve të përditshme, duke siguruar një mbështetje të drejtpërdrejtë financiare që synon të përforcojë rolin e shtetit në garantimin e një niveli minimal jetese dhe të rrisë efikasitetin e ndërhyrjeve sociale në funksion të barazisë dhe kohezionit social.

Ligjvënësi shqiptar, përmes ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar në mënyrë të qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse në njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki), nëpërmjet administratorëve socialë dhe sektorëve të shërbimeve sociale, të cilët kanë detyrimin ligjor për të hartuar dhe administruar listën e përfituesve të skemave të ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar, si dhe përcaktimin e masave konkrete të përfitimit, në përputhje me vendimet e komisioneve të vlerësimit dhe dokumentacionin përkatës¹³.

Shërbimi Social Shtetëror, në zbatim të rolit dhe përgjegjësiave ligjore, ushtron funksione monitoruese dhe kontrolluese ndaj veprimtarisë së institucioneve dhe strukturave në varësi të tij, si dhe të njësiave të vetëqeverisjes vendore, përfshirë edhe Bashkinë Fier. Në këtë kuadër, ky institucion është përgjegjës për të siguruar kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të procesit të

⁸ VKM nr.854, datë 26.12.2024 “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta, për vitin 2024”, pika a; familjet dhe individët që trajtohen me ndihmë ekonomike sipas nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfshirë edhe ata që përfitojnë nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike;

⁹ Sipas Ligjit 57/2019, pika b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë; c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;

¹⁰ VKM nr.854, datë 26.12.2024, pika ç; individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

¹¹ VKM nr.854, datë 26.12.2024, pika d; individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar;

¹² VKM nr.854, datë 26.12.2024, pika dh; ndihmësit personalë të përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, të kësaj pike.

¹³ Neni 22, pika “b” dhe neni 23 të të njëjtit ligj.

zbatimit të legjislacionit në fushën e asistencës sociale, duke garantuar respektimin rigoroz të dispozitave ligjore dhe nënligjore të zbatueshme në këtë fushë. Referuar informacionit të përcjellë nga Shërbimi Social Shtetëror, citojmë; *në bazë të VKM nr. 854, datë 26.12.2024 "Për mbështetjen financiare për kategori të veçanta", është bërë njoftimi për çdo bashki për kryerjen e pagesave mbi listëpagesat e muajit dhjetor, por gjithmonë duke marrë në konsideratë të gjitha vendimet e gjeneruara gjatë gjithë muajit dhjetor për komisionimet dhe rikomisionimet e aftësisë së kufizuar. Në korrespondencë të vazhdueshmëe njoftimesh, ju është komunikuar përfshirja në pagesën e fundvitit duke i rishikuar listëpagesat e gjeneruara.*

Sa më sipër, Bashkia Fier, si institucion përgjegjës në nivel vendor, ka rolin thelbësor në procesin e evidentimit, hartimit dhe administrimit të listës së përfituesve nga skemat e mbështetjes ekonomike, përfshirë këtu edhe bonusin e fundvitit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 854, datë 26.12.2024, *"Për mbështetjen financiare për kategori të veçanta"*.

Lidhur me rastet objekt shqyrtimi, të qytetarëve Gazmir Harizi dhe Gëzim Ramushaj (persona me aftësi të kufizuara të nivelit të dytë) vihet re se këta përfitues i plotësojnë kriteret procedurale dhe afatet kohore të parashikuara në VKM nr 854, datë 26.12.2024, fakt ky i konfirmuar edhe nga përgjigja e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier. Konkretisht;

G. H. ka aplikuar për rikomisionim në datën 05.11.2024, intervista është zhvilluar më datë 07.11.2024 dhe vendimi nr. AK_2024-034390 për aftësinë e kufizuar është marrë më datë 01.12.2024 duke i njohur aftësinë e kufizuar për periudhën 01.12.2024-01.12.2025.

G. R. ka aplikuar për rikomisionim në datën 22.11.2024, intervista është zhvilluar më datë 26.11.2024 dhe vendimi nr. AK_2024-036724, për aftësinë e kufizuar, është marrë më datë 01.12.2024 duke i njohur aftësinë e kufizuar për periudhën 01.12.2024-01.12.2025.

Vendimi është përcjellë pranë Njesisë Administrative Frakull, Bashkia Fier, më 13.12.2024, me shkresën nr. prot. 1326.

Megjithatë, pavarësisht këtyre fakteve dhe veprimeve në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, qytetarët nuk janë përfshirë në listën e përfituesve të bonusit të fundvitit. Ky mosveprim përbën një mungesë të qartë të mospërmbylljes së detyrimeve ligjore nga ana e punonjësve të Bashkisë Fier, shkaktuar nga një qasje joprofesionale, e cila ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta negative për qytetarët e prekur, duke i përjashtuar padrejtësisht nga një mbështetje

financiare që i takonte me ligj dhe duke i vendosur në një situatë të padrejtë dhe të rënduar ekonomike, duke iu mohuar ndihma që shteti u ka ofruar përmes instrumenteve të mbrojtjes sociale.

Për më tepër, referuar përgjigjeve zyrtare të Bashkisë Fier vërehet se kjo problematikë e ngritur nga ankuesit, nuk përbën një rast të izoluar, por është pjesë e një problematike më të gjerë, që ka prekur edhe individë të tjerë në procese të ngjashme rikomisionimi. Konkretisht, citojmë¹⁴:

Ka patur shumë dosje për rikomisionim atë muaj, jo vetëm nga Komisioni Biopsiko-Social, por edhe nga Komisionet Eprorë të Verbërisë apo tetraplegjikëve, të cilët për të njëjtën arsye nuk kanë përfituar shpërblimin.

Kjo situatë tregon për një mangësi strukturore në menaxhimin institucional të rasteve në kohë, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta për disa kategori vulnerabël të cilëve u është cenuar e drejta për përfitime të garantuara me ligj.

Avokati i Popullit vlerëson se cilado qoftë ngarkesa apo volumi i punës në institucionet publike, kjo e fundit nuk mund të shërbejë si justifikim për moszbatimin e detyrimeve ligjore dhe akteve nënligjore që burojnë prej tyre. Mungesa e përfshirjes në listpagesë e individëve që kanë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për përfitim, për shkak të neglizhencës apo vonesave administrative, përbën jo vetëm cënim të të drejtave të tyre, por gjithashtu bën ndesh me parimin e shtetit të së drejtës dhe me përgjegjësinë institucionale për garantimin e mbrojtjes sociale në mënyrë të barabartë dhe efektive. Institucionet publike, veçanërisht në raport me grupet më të pambrojtura, nuk mund të justifikojnë mosveprimin me vështirësitë e brendshme operative, pasi zbatimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve nuk janë çështje diskrecioni, por detyrim i patjetërsueshëm.

Referuar Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 52, kryerja e shpenzimeve të fondeve të miratuara nga buxheti i shtetit dhe ai vendor duhet të realizohet deri në fund të vitit buxhetor përkatës. Udhëzimi nr.13, datë 18.12.2024 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024” Kreu IV, pika 5, përcakton se brenda datës 27.01.2025 duhet të përfundojë paraqitja dhe regjistrimi në SIFQ i të gjitha shpenzimeve të konstatuara gjatë vitit 2024. Për rrjedhojë, përdorimi i fondeve të vitit 2024 për përfitime si shpërblimi i fundvitit është një detyrim ligjor që duhet të realizohet brenda afateve të përcaktuara dhe çdo vonesë apo mosveprim që pengon

¹⁴ Përgjigjet e Bashkisë Fier me shkresat përkatëse të sipërcituara.

zbatimin e këtij detyrimi sjell pasoja direkte për qytetarët dhe përbën cënim të të drejtave të tyre.

Sa më sipër, Avokati i Popullit vlerëson se jemi në kushtet e shkeljes së të drejtës për kujdes social nga ndihma shtetërore, një e drejtë që nuk buron vetëm nga Ligji nr. 57/2019, por është e sanksionuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ku Shqipëria është palë. Mospërfshirja e qytetarëve në një përfitim ekonomik të garantuar nga aktet nënligjore, në kushtet kur janë përmbushur të gjitha kriteret dhe procedurat ekëtrura nga ligji, bie ndesh me frymën e mirëqeverisjes, me parimet e barazisë dhe të mbrojtjes së grupeve vulnerabël. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit sipas të cilit qeverisja duhet të ushtrohet në nivelin më të afërt me qytetarin dhe të realizojë në mënyrë efektive funksionet publike, është përgjegjësi direkte e njësive të vetëqeverisjes vendore të sigurojë qasje të barabartë dhe efektive në të gjitha format e mbështetjes sociale si dhe të bashkëveprojë në mënyrë proaktive në përmbushje të misionit të tyre për garantimin e një jetese dinjitoze për individët dhe familjet në nevojë. Bashkia Fier, në këtë rast ka dështuar të zbatojë jo vetëm ligjin në mënyrë formale, por dhe frymën e tij që synon mbrojtjen e dinjitetit njërëzor dhe përmirësimin e jetesës për individët në nevojë. Ky qëndrim bie ndesh dhe me angazhimet që rrjedhin edhe nga procesi i integritetit evropian të vendit tonë, ku rritja e standartave të shërbimeve publike është një nga prioritetet kryesore.

Nga ana tjetër, në linjë me qasjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe veçanërisht të grupeve vulnerabël, institucioni i Avokatit të Popullit thekson se adresimi i varfërisë, si një fenomen kompleks që ndikon në gëzimin e të drejtave themelore, kërkon një ndërhyrje të koordinuar, të menjëhershme dhe me përgjegjësi institucionale nga institucionet përgjegjëse publike. Ofrimi i ndihmës konkrete dhe garantimi i aksesit në shërbime bazë sociale janë pjesë përbërëse e standardeve që përbëjnë themelet e një mirëqeverisjeje efektive.

E drejta për mbështetje nga shteti nuk është një privilegj, por një detyrim i pandashëm institucional dhe një garanci thelbësore e shtetit të së drejtës. Në raste të tilla, ku qasja jo profesionale e një institucioni mohon qytetarit ndihmën më minimale për dinjitetin dhe mirëqenien e tij, përgjegjësia është e qartë dhe kërkon jo vetëm reflektim, por dhe ndërhyrje të menjëhershme për rikthimin e të drejtës së cënuar dhe parandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen. Në këtë kuptim, përgjigja e institucioneve përgjegjëse duhet të jetë urgjente, dhe e koordinuar dhe në mbështetje të sa më shumë kategorive në nevojë. Ofrimi i ndihmës konkrete dhe i mjeteve bazë të jetesës, për të përballuar dhe kapërcyer sa më denjësisht situatat e vështira të familjeve në

nevojë, kërkojnë një vlerësim objektiv dhe të menjëhershëm si dhe garantim të shërbimeve bazë sociale

Institucioni i Avokatit të Popullit monitoron me shumë vëmendje, masat e marra nga autoritetet për kategoritë më të rrezikuara me qëllim garantimin e jetesës normale/ dinjitoze për shtresat në nevojë. Mbështetja për sigurimin e standardit më të lartë të të drejtave të njeriut, së bashku me mbrojtjen e anëtarëve më të prekshëm të komuniteteve tona nga një kërcënim ekzistencial, është qëllim legjitim.

Në vijim, Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”;

REKOMANDON

- 1. Të merren masa të menjëhershme nga ana e Bashkisë Fier për vendosjen në vend të së drejtës së shkelur për përfitimin e bonusit të fundvitit, për qytetarët G. H. dhe G. R., si dhe për çdo përfitues tjetër që ka plotësuar kriteret, dokumentacionin dhe afatet e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 854, datë 26.12.2024 dhe i është mohuar padrejtësisht kjo mbështetje financiare për shkak të mosveprimeve administrative të pajustificueshme, në mënyrë që të garantohet barazia dhe trajtimi i drejtë përpara ligjit.*
- 2. Të verifikojë me përgjegjësi institucionale zinxhirin e veprimeve dhe mosveprimeve administrative që çuan në mospërfshirjen në kohë të përfituesve në listëpagesat e dhjetorit 2024.*
- 3. Të forcojë kapacitetet teknike dhe organizative të strukturave përgjegjëse, duke përfshirë përgatitjen e planeve të posaçme për menaxhimin e rasteve në periudha me ngarkesë të lartë, si fundviti, me qëllim garantimin e zbatimit korrekt dhe në kohë të vendimeve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.*

4. *Të merren masa për të përmirësuar mbështetjen sociale në nivel vendor, me qëllim krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin efektiv të politikave të reja të mbështetjes sociale. Në këtë kuadër, është e domosdoshme organizimi i trajnimeve të detyrueshme për personelin e strukturave të shërbimeve sociale dhe administratorët socialë, të fokusuara në zbatimin e ligjit nr. 57/2019, aktet nënligjore në fuqi, si dhe përgatitjen e listëpagesave, me synim rritjen e profesionalizmit dhe ndjeshmërisë ndaj nevojave të grupeve vulnerabël.*
5. *Të vendosë mekanizma të brendshëm monitorimi dhe kontrolli për rastet e rikomisionimit, duke siguruar që asnjë vendim i marrë brenda afateve ligjore të mos mbetet i pazbatuar për arsye organizative apo justifikime administrative që bien ndesh me interesin publik dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditëve nga data e dërgimit.

Për, sa më sipër, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe na informoni për qëndrimin tuaj ndaj tij.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

K O M I S I O N E R

VILMA SHURDHA

DV